

**AKT – THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**" GERMAN INVEST" SHPK**

Sot me daten 16.08.2018 (dymijë e tetëmbëdhjetë), unë ortaku themelues :  
**1.Gredi Nikollaj**, i biri Vladimir lindur me 14.06.1986 në Tiranë dhe banues në Lagjen nr 5,  
Rruga Dëshmorët,Durrës,shtetas Shqiptar ,mbajtës i kartës se identitetit Nr 028794708.

Në përputhje me Ligjin nr.9901 Datë 14.04.2008, si edhe Ligjin nr.9723 datë 3.5.2007,  
nenet 26,28,32 e 35 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit",  
Kam vendosur të themeloj *Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar* "GERMAN INVEST"  
SHPK.

**NENI 1.**  
**EMËRTIMI I SHOQËRISË**

Shoqëria do të quhet "GERMAN INVEST" SHPK.

**NENI 2**  
**SELIA E SHOQËRISË**

Shoqëria do të ketë selinë e saj në, Qytetin e Durrësit, në Lagjen nr 5, Rrugën  
Dëshmorët,Pallati 613, Kati 2 (dytë),hyrja nr 4.Shoqëria mund të krijojë filiale, zyra  
perfaqësimi, në përputhje me legjislacionin shqipëtar.

**NENI 3**  
**OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj ne fushen e:

- Kujdes mjekësor dhe ndërtim spitalesh.
- Klinikë mjekësore për kafshë.
- Tregëti pasurish të paluajtshme.
- Ndërmjetësim për shitje pasurish të paluajtshme.
- Tregëti makinash, import-eksport.
- Agjensi turistike.
- Shërbime sigurie të mbrojtjes fizike.
- Agjensi punësimi për brenda dhe jashtë Shqipërisë.
- Dhënie makinash me qera.
- Tregëti lulesh, import-eksport.
- Rritje shpendësh dhe tregëtim të tyre.

**NENI 4**  
**KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË**

Kapitali themeltar i shoqërisë "**GERMAN INVEST**" SHPK është 100.000 (njëqind mijë)  
lekë.



Ky kapital është i ndarë në 1 kuotë, secila me vlerë nominale 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Kontributi i ortakeve është i ndare si vijon:

**1.Gredi Nikollaj, zotëron 1 kuotë baraz me 100 % të kapitalit.**

#### **NENI 5**

#### **KOHËZGJATJA E SHOQËRISË**

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhë kohe të pacaktuar.

#### **NENI 6**

#### **ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

Administrator i shoqërisë do të jetë **Z.Gredi Nikollaj**, i cili emërohet për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë ripërtëritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të ortakëve, që përfaqësojnë me tepër se gjysmen e pjesëve të kapitalit themeltar.

Administratori ka të gjithë kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretë në emër të shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep ortakëve.

Administratori mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë.

Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose të tretëve për shkelje të ligjeve,statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

#### **NENI 7**

#### **ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE**

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit "Per Shoqërite Tregtare".

2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

#### **NENI 8**

#### **NDARJA E FITIMEVE**

Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi i vitit financiar ,të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për rezervën , si dhe duke i shtuar apo zbritur fitimet ose humbjet e mbartura nga vitet e mëparshme.

#### **Neni 9**

#### **LIKUIDIMI**

Shoqëria është në likuidim e sipër që në momentin e prishjes së saj , operacion i cili do të kryhet sipas kërkesave të parashikuara në legjislacionin tregtar shqipëtar.

**NENI 10**  
**MOSMARREVESHJET**

Mosmarrëveshjet zgjidhen me mirëkuptim. Në rast të kundërt, ortakët do t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Durrës për zgjidhje.

**ORTAKU THEMELUES I SHOQËRISË**  
**"GERMAN INVEST" SH.P.K**

**Gredi Nikollaj**

*Gredi Nikollaj*

